



## Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 16.05.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës **13.05.2022** të parashtruar nga **OE Consult Engineering Shpk - Kaçanik**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Shërbime profesionale ne procesin e legalizimit te ndërtimeve pa leje**, me Nr. të Prok: **616-22-2865-2-1-1 dhe numër te brendshëm 616 22 \_\_\_ 211** nxjerr:

### V E N D I M

**Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim OE **Consult Engineering Shpk - Kaçanik**, -, të dt. **13.05.2022** lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Shërbime profesionale ne procesin e legalizimit te ndërtimeve pa leje”**, me Nr. të Prok: : **616-22-2865-2-1-1 dhe numër te brendshëm 616 22 031 211**, kundër *Njoftimit për kontrate* te AK –së, të datës **07.04.2022**.

1. Vërtetohet Njoftimi për kontrate i Autoritetit Kontraktues i dates **07.04.2022**.
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit per tenderin* **“Shërbime profesionale ne procesin e legalizimit te ndërtimeve pa leje”**, me Nr. të Prok: **616-22-2865-2-1-1 dhe numër te brendshëm 616 22 031 211**, sipas Njoftimit për kontrate te publikuar me datën: **07.04.2022**..
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### A r s y e t i m

OE **Consult Engineering Shpk - Kaçanik** me datë 13.05.2022, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull **“Shërbime profesionale ne procesin e legalizimit te ndërtimeve pa leje”**, me Nr. të Prok: **616-22-2865-2-1-1 dhe numër te brendshëm 616 22 031 211**.

Autoriteti Kontraktues, me datë **07.04.2022**, ka bere Njoftimin për kontrate për **“Shërbime profesionale ne procesin e legalizimit te ndërtimeve pa leje”** . Ne njoftimin për kontrate dhe ne e dosjen e tenderit ne piken 13.1 te FDP eshte parapare qe OE te cilet kane paqartesi deri

me daten 28.04.2022 te kene te drejten per te bere kerkese per sqarim te aplikacioneve. Deri me ate date AK ka pranuar dy kerkesa per sqarime dhe se per te dy kerkesat ka dhene sqarimet e duhura dhe se kane qen publike per te gjitha OE, te drejte te cilen e keni pasur edhe ju si OE.

Edhe ju si OE keni pasur mundesin sikurse te gjitha OE ti paraqitni shqetesimet e juaja dhe te parashtroni kerkese per sqarime shtese por nuk e keni shfrytezuar kete te drejte qe ju ka takuar, andaj nese ju kishit kerkuar sqarime shtese, AK nese kishte pare te arsyeshme do te jepte pergjigjet e duhura gjithnje duke u mbeshtetur ne rregullat e LPP dhe ne RRUPP.

Me daten 10.05.2022 AK ka bere korigjimin e nevojshem te kriterëve gjithnje duke u mbeshtetur ne kerkesat e OE dhe po ashtu me daten 10.05.2022 ka ngarkuar ne platformen e E-prokurimit dokumentin e parakualifikimit me korigjime.

Te gjitha pretendimet e paraqitura nga ana juaj nuk qendrojn, per arsye se AK ne menyre shume te qarte ka dhene sqarimet e duhura ne pyetjet e parashtruara nga OE tjere .

AK duke u mbështetur ne Parimet e përgjithshme te LPP , përkatësisht ne nenin 7 Barazia ne trajtim / jo diskriminim qe thotë se AK do ti trajtoj operatoret ekonomik ne mënyrë te barabarte jo diskriminuese dhe ne mënyrë transparente, duke u mbështetur ne Rregullat për Specifikimet teknike dhe dosjen e tenderit ka bere ndryshime dhe ka lehtesuar te gjitha kerkesat e kerkuara ne Njoftimin per kontrate dhe ne Dosjen e parakualifikimit te dates 07.04.2022.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

**Departamenti i Prokurimit**